

## V E N D I M

### “NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej

**GJYQTAR: Ibrahim HOXHA**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Malvina MALAJ**, me pjesëmarrjen e prokurorit **Ndini Tavani**, sot më datë 09.10.2015, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike kërkesën penale me Nr..... Akti, që i përket:

#### KËRKUES:

**Shoqëria “Shërbimi Përmbarimr .....” sh.p.k.**, me NIPT L02110003A, me adresë Bulevardi “.....”, Rruga “.....”, Nr.1, Q....., Tiranë, përfaqësuar në gjykim me autorizim datë me 16.10.2015 nga Dritan Brahimi.

#### KUNDER:

Vendimit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 05.10.2015 të Prokurorit Ndini Tavani pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me procedimin penal Nr..... te vitit 2015 për vepren penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, për të cilin është mbajtur procesverbal “Mbi sekuestrimin e sendeve” datë 06.10.2015 nga Of. Pol. Gjyqësore Rison Puka dhe Urim Buci.

#### BAZA LIGJORE:

Neni 212 e vijues i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën në tërësi, dëgjoi palët që kërkuar:

1. **Kërkuesi:** Pranimin e kërkesës dhe prishjen e vendimit të marrë nga organi i Prokurorisë.
2. **Prourori:** Rrëzimin e kërkesës.

Në përfundim të gjykimit,

#### V Ë R E N:

Se kërkuesi Shoqëria “Shërbimi Përmbarimr .....” shpk i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një kërkesë ankimore duke kërkuar prishjen e vendimit të prokurorisë për sekuestrimin e sendeve si mësipër.

Kjo kërkesë është e pabazuar dhe duhet rrëzuar për shkaqet e mëposhtëme:

Kërkuesi Shoqëria “Sherbimi Përmbarrimror .....” shpk rezulton se shtrin funksionin e saj për ekzekutimi e urdhërimeve të Gjykatës sipas vendimeve gjyqësore për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit ndaj titujve ekzekutiv sipas parashikimeve të nenit 510 të K.Pr.Civile me kërkes të palës kreditore. Në rastin konkret me kërkes të palës kreditore Raiffeizen Bank sha janë rregjistruar dhe vënë në lëvizje, ekzekutim vendimet gjyqësore për të cilat është lëshuar dhe urdhëri I ekzekutimit nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë. Konkretisht për vendimet gjyqësore: Nr.2770 Akti datë 28.04.2015; Nr.2769 Akti datë 23.04.2015; Nr.2771 Akti datë 28.04.2015; Nr.2563 Akti datë 24.04.2015; Nr.2766 Akti datë 28.04.2015; Nr.2768 Akti datë 28.04.2015; Nr.3061 Akti datë 08.05.2015; Nr.2969 Akti datë 06.05.2015; Nr.2765 Akti datë 24.04.2015; Nr.2764 Akti datë 29.04.2015; Nr.23402 Akti datë 19.05.2015 dhe Nr.3684 Akti datë 27.05.2015.

Për këto vendime gjyqësore “Shërbimi Përmbarrimor .....” shpk, bazuar në nenet 517,518,519,525 të K.Pr.Civile, ndërmori veprimet e duhura ligjore duke filluar ekzekutimin ndaj palës debitore Shoqëria “E.....” shpk, e cila nuk kishte përmbushur detyrimet kontraktuale sipas kontratave të kredisë të lidhura me palën keditore Raiffeizen Bank sha. Pas veprimeve të Shoqëris “Sherbimi Përmbarrimore .....” shpk, nga nana e palës debitore Shoqëria “E.....” shpk është bërë kallzim penal pranë prokurorisë për shpërdorim detyre nga përmbarruesi gjyqësor gjatë ekzekutimit të këtyre vendimeve. Pas kallzimit nga ana e organit të akuzës është nxjerrë vendimi për sekuestrimin e sendeve datë 05.10.2015. Në datën 06.10.2015 nga OPGJ-ja është shkuar në “Shërbimin Përmbarrimor .....” shpk dhe është bërë sekuestrimi i sendeve për të cilat është mbajtur procesverbal mbi sekuestrimin e sendeve.

“Shërbimi Përmbarrimor .....” shpk, bazuar në nenin 212 të K.Pr.Civile e kundërshton këtë veprim të organit të akuzës duke pretenduar se po pengohet në mënyrë të padrejt në ushtrimin e detyrës së tij për ekzekutimin e titujve ekzekutiv nga ky veprim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë e për rrjedhojë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shfuqizimin e vendimit të mësipër të prokurorisë.

Neni 212 i K.Pr.Penale ka përcaktuar se *“I pandehuri, pesoni tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtën e kërimit të tyre, mund të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit”*.

Mënyra e formulimit të këtij neni dhe K.Pr.Penale i kanë dhënë të drejtë Gjykatës që të shqyrtojë një veprim të kryer nga organi i akuzës me kërkesë ankimore të palës që preket nga ky veprim.

Në rastin konkret kallzimi është bërë për veprimet që ka kryer përmbarruesi gjyqësor për të cilin është bërë kallzim për shpërdorim detyre, vepër penale kjo e parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Sendet e sekuestruar nga ana e organit të

akuzës janë sende objekt i hetimit të çështjes për të cilën është filluar dhe hetimi në bazë të kallzimit të palës debitore Shoqëria “E.....” shpk.

Në këtë veprimi i kryer nga OPGJ-ja në bazë të vendimit të nxjerrë nga prokurori i çështjes për sekuestrimin e sendeve si mësipër është i drejtë dhe i bazuar në nenin 208 dhe 214 të K.Pr.Penale për rrjedhojë, **Gjykata nuk mund të prishë vendimin e prokurorisë.**

Për këto arsye, Gjykata krijoi bindjen se kërkesa është e pa bazuar në prova dhe në ligj dhe duhet të vendos rrëzimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata bazuar në nenin 212 të K.Pr.Penale,

### **VENDOSI:**

- Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Shoqëria “Shërbimi Permbartimor .....” sh.p.k.
  - Shpenzimet proceduriale i ngarkohen kërkuarit.
  - Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
6. **U shpall sot në Tiranë, datë 21.10.2015.**

**SEKRETARE**

**Malvina MALAJ**

**GJYQTAR**

**Ibrahim HOXHA**